



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22.4.2023

Nr: 3

Ora: 12:00

UDHËZIM

PËR

**MIRATIMIN E MODELIT TË AKTMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
NDËRMJET PARTISË POLITIKE QË PËRFITON FONDE NGA BUXHETI I SHTETIT DHE  
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “d”, “dh”, “ë”, “k”, e 2, dhe nenit 88, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Partisë Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 22.4.2023 Nr: 3  
Ora: 12:00



“Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Partisë Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

AKTMARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë \_\_.\_\_.202\_\_, nënshkruhet kjo aktmarrëveshje bashkëpunimi midis palëve:

**I) KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

1. \_\_\_\_\_  
(Emër, Atësia, Mbiemër)

2. Adresa \_\_\_\_\_

3. Tel/Cel \_\_\_\_\_ 4. Email \_\_\_\_\_

**I) TË DHËNAT E PARTISË POLITIKE**

1. Partia Politike \_\_\_\_\_ Shkronjat nistore \_\_\_\_\_

3. Kryetari \_\_\_\_\_ 4. Selia \_\_\_\_\_  
(Emër,

5. NIPT \_\_\_\_\_ 6. Përfaqësuar \_\_\_\_\_  
nga \_\_\_\_\_  
(Emër, Mbiemër)

Palët bien dakord të lidhin këtë aktmarrëveshje bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si “aktmarrëveshje”) me kushtet si më poshtë vijon:





## **Neni 1**

### **Qëllimi i aktmarrëveshjes**

Qëllimi i kësaj aktmarrëveshjeje është angazhimi i palëve për përdorimin e fondeve të përfituara nga Buxheti i Shtetit dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe që i jepen partisë politike përfituese, në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

## **Neni 2**

### **Baza Ligjore**

Kjo aktmarrëveshje hartohet në bazë të nenit 88 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **Neni 3**

### **Detyrimet e Partisë Politike**

Partia Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr përsipër:

1. Të pranojë fondin e dhënë dhe ta përdor atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Të pranojë monitorimin e shpenzimeve të fondeve të dhëna për të si subjekt zgjedhor dhe kandidatëve të tij.
3. Të respektojë të gjitha ndalimet dhe kufizimet që përcaktohen në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Në rast se partia politike nuk zbaton përcaktimin e bërë në nenin 88, pika 7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, atëherë përjashtohet nga e drejta për të përfituar fonde publike për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet, përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjobën.

Miraturar me udhëzimin nr. 3, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Partisë Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.





## Neni 4

### Deyrimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve merr përsipër:

1. Të përcaktojë dhe të shpërndajë fondin e përcaktuar për secilën parti politike jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga regjistrimi i listave shumëmemërore ose kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore të partisë përkatëse.
2. Të monitorojë nëpërmjet administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve apo subjekteve të kontraktuara prej tij respektimin e detyrimeve ligjore të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre për shpenzimet e tyre në fushatën zgjedhore.

## Neni 5

### Pikat e kontaktit

Për zbatimin e kësaj aktmarrëveshjeje palët përcaktojnë këto pika kontakti:

I) KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	1. Z. /Zj.	<input type="text"/>
		(Emër, Mbiemër)
	2. Email	<input type="text"/>
	3. Tel/Cel	<input type="text"/>
	4. Adresa	<input type="text"/>

I) PARTIA POLITIKE	1. Z./Zj.	<input type="text"/>
		(Emër, Mbiemër)
	2. Email	<input type="text"/>
	3. Tel/Cel	<input type="text"/>
	4. Adresa	<input type="text"/>



Miraturar me udhëzimin nr. 3, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Partisë Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve".



## Neni 6

### Auditimi dhe monitorimi

Partia politike pranon auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të fushatës zgjedhore sipas nenit 92/6 të Kodit Zgjedhor, si dhe monitorimin e aktivitetit të saj gjatë fushatës zgjedhore dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve sipas nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, pavarësisht faktit nëse regjistrohet më vete si subjekt zgjedhor apo në kuadër të një koalicioni zgjedhor.

## Neni 7

### Angazhim i përbashkët

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Partia Politike \_\_\_\_\_ angazhohen të shqyrtojnë në mënyrë të ndërsjelltë kërkesat dhe propozimet e dyanshme dhe të mbajnë kontakte të rregullta nëpërmjet strukturave përgjegjëse.

## Neni 8

### Dispozita të fundit

Palët me vullnet të lirë marrin përsipër të respektojnë dhe të përmbushin detyrimet sipas kësaj aktmarrëveshjeje.

Kjo aktmarrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Tiranë më \_\_.\_\_. 202\_\_

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

**Partia Politike**

**Kryetari/Përfaqësuesi \_\_\_\_\_**



Miraturar me udhëzimin nr. 3, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Partisë Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve".